

VENDIM
Nr. 506, datë 6.7.2016

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 796, DATË 22.9.2015, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR NDRYSHIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT, NGA MINISTRIA E MBROJTJES TE MINISTRIA E DREJTËSISË, PËR DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BURGJEVE, TË PRONËS NR. 98, ME EMËRTIM “GRUP DEPO (ISH-REPARTI USHTARAK NR. 5011)”, ME VENDNDODHJE NË BRAR, TIRANË, PËR DHËNIEN NË PËRDORIM TË PËRKOHSHËM TË DISA OBJEKTEVE E TË NJË SIPËRFAQEJE TRUALLI FUNKSIONAL, BRENDA TERRITORIT TË PRONËS NR. 6, ME EMËRTIM “INSTITUTI GJEOGRAFIK I USHTRISË”, ME VENDNDODHJE NË RRUGËN “MYSLYM KETA”, TIRANË, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 515, DATË 18.7.2003, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, QË I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES”, TË NDRYSHUAR”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 10, 12, 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në pikën 1, të vendimit nr. 796, datë 22.9.2015, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, fjalët “... dhe dhënie në përdorim të përkohshëm, për një periudhë 30-vjeçare, të disa objekteve, si dhe të një sipërfaqeje trualli funksional, me sipërfaqe të përgjithshme prej 5 931,2 (pesë mijë e nëntëqind e tridhjetë e një presje dy) m², brenda territorit të pronës nr. 6, me emërtim “Instituti Gjeografik i Ushtrisë”, me vendndodhje në rrugën “Myslym Keta”, Tiranë, sipas planvendosjeve që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij, për t’u përdorur për vendosjen e administratës së Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe për plotësimin e nevojave institucionale të këtij institucioni ...”, shfuqizohen.


2. Ngarkohen ministri i Drejtësisë, ministri i Mbrojtjes, drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve, Agjencia e Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave të Paluajtshme dhe kryeregjistruesi i Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

PLAN VENDOSJA E REP. USHT. 7030, Prona nr.6
pjesa që do t'i jepet në përdorim Ministrisë së Drejtësisë për Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve

SISTEMI I KOORDINATAVE SHETERORE



PUNOI
TOP. NIKOLL TUSHI

SHKALLA 1 : 1000

DREJTORI I IGJIU
N/KOLONEL ZYDI ALCANI

